

R A P O R T

I DËGJIMEVE BUXHETORE

PËR

KAB 2026-2028

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	03/06	25	
Nj. Org.	Numër		
01	060/04-20337		



KOMUNA E DRENASIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



R A P O R T
I
DËGJIMEVE BUXHETORE
PËR
KORNIZEN AFATMESME BUXHETORE
[KAB 2026-2028]



Qershor, 2025

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Qëllimi dhe rëndësia e dëgjimeve buxhetore.....	4
Organizimi dhe vendndodhja.....	4
Dëgjimi i parë publik.....	7
Dëgjimi i dytë publik.....	8
Temat kryesore të trajtuara.....	9
Deklarimet kryesore.....	9
Pyetjet e qytetarëve dhe përgjigjet e institucioneve.....	10
Analiza e pjesëmarrjes sipas gjinisë.....	17
Përfundime dhe rekomandime.....	20

Hyrje

Ky raport pasqyron rezultatet e dy dëgjimeve buxhetore të organizuara nga Komuna e Drenasit, të mbajtura në kuadër të procesit të hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2026–2028. Këto dëgjime përfaqësojnë një pjesë thelbësore të angazhimit të komunës për të garantuar një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent të vendimmarrjes për çështjet financiare që prekin drejtpërdrejt jetën dhe mirëqenien e qytetarëve të saj.

Qëllimi kryesor i organizimit të këtyre dëgjimeve publike ka qenë të krijohet një platformë efektive për të informuar komunitetin mbi prioritetet buxhetore, të mbledhen mendimet, propozimet dhe sugjerimet nga grupet e interesit, dhe të mundësohet pjesëmarrja aktive e qytetarëve, shoqërisë civile, përfaqësuesve të fshatrave, bizneseve, grave, të rinjve dhe kategorive të tjera të veçanta. Përmes këtij procesi, Komuna e Drenasit synon të forcojë lidhjen ndërmjet institucioneve dhe komunitetit lokal, duke promovuar praktika të qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies.

Të dy dy dëgjetet buxhetore janë zhvilluar në përputhje me kornizën ligjore dhe udhëzimet administrative për planifikimin dhe menaxhimin e financave publike, si dhe kanë pasur si objektiv identifikimin dhe adresimin e nevojave dhe prioritetëve më të rëndësishme për komunitetin në vitet në vijim. Për më tepër, konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga këto takime do të reflektohen në draftimin e dokumenteve buxhetore, duke garantuar që planifikimi financiar të bazohet në të dhëna reale dhe nevoja konkrete të qytetarëve.

Ky raport, përveçse është një pasqyrim i përmbajtjes dhe ecurisë së dëgjimeve, shërben edhe si një dëshmi e përkushtimit të Komunës së Drenasit për të vazhduar praktikatat e përfshirjes aktive të publikut në proceset e rëndësishme vendimmarrëse.

Raporti fokusohet në deklarimet kryesore, pyetjet e parashtruara nga qytetarët dhe përgjigjet zyrtare, si dhe një analizë të pjesëmarrjes sipas gjinisë.

Qëllimi dhe rëndësia e dëgjimeve buxhetore

Qëllimi kryesor i këtyre dëgjimeve ishte të mundësojë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe përfaqësuesve të interesit në përcaktimin e prioriteteve buxhetore të komunës, duke u ofruar atyre një hapësirë konkrete për të shprehur shqetësimet, idetë dhe propozimet e tyre. Dëgjimet buxhetore janë një mekanizëm thelbësor që forcojnë llogaridhënien publike, sepse obligojnë administratën komunale të japë shpjegime të qarta për planifikimin dhe ndarjen e burimeve financiare, duke siguruar që politika fiskale të reflektojë realisht nevojat, kërkesat dhe prioritetet e komunitetit lokal.

Ky proces është gjithashtu një mjet efikas për të rritur transparencën institucionale, për të ndërtuar një kulturë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve dhe për të nxitur një dialog konstruktiv mbi mënyrën se si menaxhohen të ardhurat dhe shpenzimet publike. Angazhimi aktiv i qytetarëve rrit besimin ndaj qeverisjes vendore dhe ndihmon në optimizimin e shpenzimeve publike, pasi vendimet marrin një bazë më të fortë dhe më të drejtë, të mbështetur në interesin e përgjithshëm të komunitetit.

Organizimi dhe vendndodhja

Pas themelimit të Grupit Punues për dëgjimet buxhetore 2025–2027, sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Drenasit nr. 01-400/01-8037, të datës 27/02/2025, dhe shpalljes së ftesës për pjesëmarrje në dëgimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028, nr. 01-060/03-18323, të datës 19/05/2025, janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar një proces të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent. Këto veprime janë bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Kryetari Ramiz Lladrovci, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, ka publikuar kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarët për përgatitjen e KAB-it 2026–2028. Ftesa dhe të gjitha informacionet përkatëse janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës (<https://glllogoc.rks-gov.net/news/f-t-e-s-e-21/>), në platformën për konsultime publike (<https://konsultimet.rks-gov.net/>) dhe në faqen zyrtare në Facebook (<https://www.facebook.com/komunadrenas/>), për të garantuar transparencë dhe qasje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit.

Të gjithë qytetarët, administratorët e vendbanimeve, përfaqësuesit e lagjeve, OJQ-të, shoqatat e grave, shoqëria civile, bizneset dhe palët e tjera të interesuara janë njoftuar se më datën

19.05.2025 kanë filluar dëgjimet buxhetore për pranimin e komenteve, propozimeve dhe kërkesave për hartimin e KAB-it 2026–2028. Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft-Buxheti Komunal 2026–2028 kanë qenë dhe mbeten dokumente me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe mirëqenien e komunës, prandaj pjesëmarrja aktive e qytetarëve ka qenë thelbësore për të ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Komentet dhe propozimet janë pranuar deri më 30.05.2025, ora 16:00, në adresat zyrtare të emailit: albulena.saliuku@rks-gov.net, bekim.dobra@rks-gov.net, avdyl.mziu@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net. Publikimi i detajuar i ftesave dhe hapja e kanaleve të komunikimit dëshmojnë përkushtimin e Komunës së Drenasit për të garantuar një proces vendimmarrës të bazuar në nevoja reale dhe të mbështetur në pjesëmarrjen aktive të komunitetit.

Foto ilustrim - 1: Ftesa e publikuar



Ftesë

Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve me publike me qytetarë për përgatitjen e KAB-it (Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028).

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit dhe gjithë të interesuarit, se më datën **19.05.2025**, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të pranuar komentet, sugjerimet, propozimet dhe kërkesat hartimin e **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028**.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2026-2028 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoheni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

Komentet, kërkesat, propozimet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më 30.05.2025 orën 16:00, në e-mail-at e zyrtarëve: albulena.saliuku@rks-gov.net; bekim.dobra@rks-gov.net; avdyl.mziu@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje, për organizimin e konsultimit publik për KAB-in, mund t'i referoheni qarkoreve në vegëzat:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:
<https://gllgoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/>

Platformën për Konsultime Publike:
<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas/>

Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimeve:

Dëgjimet publike për KAB 2024	Data e mbajtjes së dëgjimeve	Vendi	Ora
Dëgjimi i parë publik me grupe të nënperfaqësuar (administratorë të vendbanimeve, këshillat lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtor shëndetësor, etj).	26.05.2025	Salla e Kuvendit	10:30
Dëgjimi i dytë publik me grupe të interesit (biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj).	26.05.2025	Salla e Kuvendit	14:00

Ju mirëpresim!



Bekim Dobra

Bekim Dobra
Edhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun


Dëgjimi i parë publik

Dëgjimi i parë publik u mbajt më **26 maj 2025**, duke filluar nga ora **10:30**, në **Sallën e Kuvendit** të Komunës së Drenasit, në kuadër të procesit të hartimit të **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028**. Ky dëgjim kishte për qëllim të mundësonte diskutimin e hapur dhe shkëmbimin e ideve ndërmjet përfaqësuesve të komunës dhe qytetarëve, me fokus të veçantë tek grupet e nënpërfaqësuar në proceset e konsultimit publik.

Dëgjimi i parë ka qenë i orientuar kryesisht drejt grupeve të nënpërfaqësuar në komunë, përfshirë administratorët e vendbanimeve, këshillat lokale, gratë, të rinjtë, studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët shëndetësorë dhe kategori të tjera të interesuara. Të pranishmit kanë pasur mundësinë të paraqesin sugjerimet, nevojat dhe prioritetet e tyre për periudhën buxhetore 2026–2028, me synimin që këto të reflektohen në draft-dokumentet përfundimtare.

Pjesëmarrja aktive e këtyre grupeve në këtë dëgjim dëshmon përkushtimin e Komunës së Drenasit për të ndërtuar një proces planifikimi të hapur, gjithëpërfshirës dhe të ndershëm, ku zëri i secilit qytetar merret në konsideratë në vendimmarrje.

Foto ilustrim – 2: Njoftimi-1



Dëgjimi i dytë publik

Dëgjimi i dytë publik është mbajtur të hënën, më **26 maj 2025**, duke filluar nga ora **14:00**, në **Sallën e Kuvendit** të Komunës së Drenasit, në kuadër të procesit të hartimit të **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028**. Ky dëgjim ka pasur për qëllim të krijojë një hapësirë të hapur diskutimi dhe shkëmbimi idesh ndërmjet përfaqësuesve të komunës dhe grupeve të ndryshme të interesit, për të mbledhur propozime konkrete dhe nevoja të veçanta që do të pasqyrohen në planifikimin buxhetor për periudhën 2026–2028.

Ky dëgjim ka qenë i dedikuar posaçërisht për **grupet e interesit**, përfshirë bizneset, fermerët, organizatat joqeveritare (OJQ-të), shoqërinë civile, klubet sportive, klubet artistike dhe kategori të tjera të përfshira në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore të komunës. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të paraqesin idetë, shqetësimet dhe propozimet e tyre, duke kontribuar drejtpërdrejt në identifikimin e projekteve dhe fushave prioritare për investime dhe mbështetje financiare.

Pjesëmarrja aktive në këtë dëgjim konfirmon angazhimin e Komunës së Drenasit për të ndërtuar një proces planifikimi buxhetor gjithëpërfshirës, transparent dhe të hapur, ku zëri i çdo grupi të interesit merret realisht në konsideratë gjatë hartimit të dokumenteve strategjike.

Foto ilustrim - 3: Njoftimi - 2



Temat kryesore të trajtuara

Në të dy dëgjimet, temat kryesore ishin të fokusuara në:

- Hartimin dhe prezantimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028
- Prioritetet investuese për infrastrukturën rrugore, ujësjellësit, ndriçimin publik dhe kanalizimin
- Përmirësimin e kushteve në arsim dhe kujdes shëndetësor
- Mbështetjen për zhvillimin rural dhe bujqësinë
- Aktivitetet rinore, kulturore dhe sportive
- Rritjen e transparencës dhe digjitalizimin e shërbimeve komunale

Deklarimet kryesore

Të dyja dëgjimet buxhetore u moderuan nga udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra, i cili në hapje të takimeve ritheksoi rëndësinë e organizimit të këtyre dëgjimeve si një mekanizëm thelbësor për forcimin e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, z. Dobra nënvizoi se dëgjimet buxhetore nuk janë vetëm një detyrim ligjor, por një mundësi e drejtpërdrejtë për qytetarët dhe grupet e interesit që të japin zërin e tyre në hartimin e prioriteteve komunale. Ai theksoi se Komuna e Drenasit mbetet e përkushtuar që të dëgjojë çdo propozim dhe vërejtje, për ta reflektuar sa më drejt në Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe në dokumentet e tjera planifikuese.

Dobra rikujtoi pjesëmarrësit se edhe në takimet e kaluara publike, qasja gjithëpërfshirëse ka dhënë rezultate konkrete, duke përfshirë propozime që janë materializuar në projekte infrastrukturore, investime në arsim, shëndetësi dhe mbështetje për kategoritë e cënueshme. Ai inkurajoi të gjithë të pranishmit që të shfrytëzojnë këtë hapësirë për të kontribuar me ide dhe propozime, duke siguruar se Zyra për Komunikim me Publikun do të vazhdojë të jetë urë lidhëse mes qytetarëve dhe administratës komunale.

Në anën tjetër, Kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, në të dy dëgjimet buxhetore, iu drejtua të pranishmëve duke theksuar rëndësinë e padiskutueshme të përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit të **Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028**. Ai theksoi se pjesëmarrja aktive e komunitetit është **shtylla themelore** e një planifikimi të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm, i cili duhet të reflektojë realisht nevojat dhe prioritetet e secilit segment të shoqërisë.

Kryetari Lladrovci nënvizoi se buxheti i planifikuar për vitin 2026 kap vlerën prej **23.5 milion eurosh**, nga të cilat mbi **6 milion euro** janë të dedikuara për investime kapitale, me synimin e qartë për të përmirësuar infrastrukturën, rrjetet publike dhe cilësinë e shërbimeve komunale. Ai ritheksoi se për të arritur këtë objektiv, kërkohet një **bashkëpunim i sinqertë** mes administratës dhe qytetarëve, duke ftuar të gjithë pjesëmarrësit të paraqesin pa asnjë hezitim kërkesat, propozimet dhe idetë e tyre.

Në të dy dëgjimet morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive përkatëse komunale, të cilët dhanë sqarime të detajuara për projektet ekzistuese dhe ato të planifikuara, duke garantuar që informacioni të jetë i qasshëm, i plotë dhe i kuptueshëm për çdo pjesëmarrës. Kryetari Lladrovci e përmbylli fjalën duke siguruar se **angazhimi i përbashkët** do të jetë faktor vendimtar për një zhvillim të balancuar dhe një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit.

Pyetjet e qytetarëve dhe përgjigjet e institucioneve

Pyetjet e parashtruara në të dy dëgjimet pasqyrojnë interesat reale të komunitetit. Ato janë evidentuar, analizuar dhe trajtuar nga grupi punues, i cili, pas shqyrtimit, ka ofruar përgjigjet përkatëse. Më poshtë, këto pyetje paraqiten në formë tabelare.

Tabela e dëgjimit të parë:

Vendbanimi	Kërkuesi	Kërkesa	Statusi	Përgjigja
Korroticë e Epërme	Xhafer Dobërdolani	Diskutim për projektet e papërfunduara	Koment	Grupi punues ka shqyrtuar me kujdes diskutimet dhe komentet e parashtruara lidhur me projektet e papërfunduara dhe ka theksuar se kjo çështje është me natyrë të tillë që kërkon trajtim të veçantë. Për këtë arsye, u vlerësua se ajo nuk mund të adresohet në kuadër të këtij takimi , por do të trajtohet në një takim tjetër të posaçëm, më të përshtatshëm për

				<p>diskutime të kësaj natyre.</p> <p>Ky takim do të organizohet në kuadër të raportimit të Kryetarit të Komunës, ku qytetarëve u jepet mundësia të shprehin shqetësimet e tyre dhe të paraqesin propozime konkrete, përfshirë edhe projektet që kërkojnë ndjekje apo përfundim në periudhën e ardhshme buxhetore.</p>
Terstenik I dhe II	Bajram Qallapeku	Asfaltimi i rrugicave në disa lagje	Pjesërisht pranuar	<p>Grupi punues ka shqyrtuar me kujdes kërkesat për asfaltimin e rrugicave në disa lagje dhe ka vlerësuar se aty ku rrugët dhe rrugicat janë të regjistruara si pronë publike, do të përfshihen në projektet e asfaltimit.</p> <p>Kjo mundësohet falë mjeteve të mjaftueshme të destinuara specifikisht për asfaltimin e</p>

				<p>infrastrukturës rrugore, të cilat janë paraparë në buxhetin e vitit në vijim. Për rrugicat që ndodhen në pronësi private ose me status të paqartë pronësor, do të shqyrtohen mundësitë ligjore për zgjidhje të mëtejshme, në bashkëpunim me banorët dhe institucionet përkatëse. Komuna mbetet e përkushtuar për përmirësimin e infrastrukturës në të gjitha lagjet, sipas prioriteteve dhe mundësive buxhetore.</p>
Sankovc, Fushticë e Epërme/Poshtme	Kadri Ajazi	Rrugica, trotuar, ujësjellës, fushë sportive, ndriçim, lidhje rrugore	Pjesërisht pranuar	Ujësjellësi: nuk mund të bëhet për shkak të hetimit; fusha sportive: do ndërtohet/lejohen fushat ekzistuese; trotuarët: shqyrtohen sipas prioritetit
Gllobar	Murat Elshani	Kanalizim, fidanë dhe ujitje, ndriçim, asfaltim rrugësh, rrugë për varreza/parking, trotuar, fushë sportive	Pjesërisht pranuar	Kërkesat do listohen dhe shihen sipas prioritetit; disa punë janë në proces; për fushën sportive do vlerësohet nevoja

Kizhnarek	Imri Bajraktari	Muri mbrojtës, zgjerim rrugë/trotuar, lidhje rrugësh, kanalizim, hapje rruge, park nacional	Pjesërisht pranuar	Nëse ka ndihmë nga qeveria, do shqyrtohet
Llapushnik	Halit Gashi	Qendër ditore për persona me aftësi të kufizuara, subvencione, transport falas	Pjesërisht pranuar	Ka kufizime buxhetore dhe ligjore; disa shërbime janë nën nivelin qendror; disa subvencione janë dhënë, pritet të mundësohen përsëri
Vasilevë, Poklek i Ri/Vjetër	Zekë Kluna	Ndriçim, asfaltim, përmirësim ujësjellësi, shëtitore, asgjësim gropë septike, shkollë (ndriçim/rrethojë/ambulancë), rrugë dhe rrethojë varrezash	Pjesërisht pranuar	Jo përgjigje direkte në tekst, por në logjikë do shqyrtohet në bazë prioriteti
Lagjia Drenasi II dhe Feronikeli	Jahir Beqiri	Kopsht për fëmijë afër shkollës	Refuzohet	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën për ndërtimin e një kopshti për fëmijë në afërsi të shkollës dhe vlerëson se nevoja për hapësira të reja për arsimin parashkollor është legjitime dhe me rëndësi për komunitetin. Megjithatë, është njoftuar se projektet e tilla aktualisht janë duke u sanksionuar nga niveli qendror, për shkak të mospajtimit për

				<p>të rritur numrin e të punësuarve në sektorin e arsimit parafillor. Kjo pengesë lidhet kryesisht me çështjen e stafit – ku, pavarësisht mundësisë për ndërtim infrastrukturor, mungesa e miratimit për angazhimin e stafit të ri nga niveli qendror e bën të pamundur realizimin e projekteve të reja të këtij lloji.</p> <p>Komuna do të vazhdojë të ndjekë dhe të avokojë në vazhdimësi për krijimin e kushteve më të mira në këtë sektor, përfshirë edhe mundësinë e realizimit të kërkesës në fjalë, sapo të krijohen kushtet ligjore dhe buxhetore për të.</p>
Nekovc	Habib Gashi	Kanalizim, rrugë kryesore, mbrojtëse trotuari, fushë sportive, rruga Hysni Murseli	Pjesërisht pranuar	Rruga kryesore mund të riparohet; Hysni Murseli ka filluar por ka ngecur; fusha do shqyrtohet

Shtuticë dhe Verbovc	Islam Syla	Ndriçim, asfaltim rrugicash	Pjesërisht pranuar	Të bëhet kërkesë me shkrim për shqyrtim
----------------------	------------	-----------------------------	--------------------	---

Tabela e dëgjimit të dytë:



Vendbanimi / OJQ	Kërkuesi	Kërkesa	Statusi	Përgjigja
OJQ Shoqata e Peshkatarëve Drenica, Drenas	Florim Kiqina	Mirëmbajtja e liqenit, kontejnerë, ndihmë për garë memoriale	Pjesërisht pranuar	Liqeni është pronë e KEK-ut, komuna nuk mund të investojë; pastrimi është bërë; gara do mbështetet financiarisht
Gradicë, Likoshan	Hafiz Muja	Asfaltimi i rrugëve Mehmet Gradica, 28 Shkurti, Gani Maliqi	Pjesërisht pranuar	Disa rrugë nuk janë të parapara për momentin, disa mund të riparohen; Gani Maliqi do të përfshihet në projekte 2026-2028
Fermerët e Drenasit	Mehmet Krasniqi	Rritja e buxhetit për sektorin e bujqësisë	Pjesërisht pranuar	Të përcaktohen fushat ku kërkohet më shumë subvencionim, do mbështeten edhe nga donatorët
Art Klub "Rifat Kukaj" Drenas	Izet Avdyli	Bilancimi i buxhetit kulturë/rini/sport, dyfishimi i subvencioneve	Pjesërisht pranuar	Komisioni i pavarur bën vlerësimin dhe ndarjen sipas aktiviteteve
Shoqata e Grave	Sabrije Islami	Subvencionim me kioska	Refuzuar	Puna është vlerësuar, por nuk hyn në kuadër të buxhetit aktual
Shoqata e të Shurdhërve	Përfaqësuesi i Shoqatës së të Shurdhërve	Subvencione, objekt për aktivitete, transport	Pjesërisht pranuar	Është tentuar të ndihmohet, nuk u votua në kuvend; ka mungesë hapësire; tenderi për



				transport nuk pati ofertues
Qytetare	Florije Uka	Përkrahja e fëmijëve të veteranëve në biznes	Pjesërisht pranuar	Ka pasur grante për rini dhe start-up, mundësi për përkrahje ekziston
Ansamblë Shqipet e Drenicës	Gentrit Mulaku	Rritja e subvencioneve për kulturë	Pjesërisht pranuar	Grupi punues në shqyrtimin e kë shqyrtimin e kësaj kërkesë siguruan ka patur dhe do të ketë rritje të subvencioneve edhe në të ardhmen.
Korroticë e Ulët	Fitore Fetahu	Subvencionim me pajisje, hapje dyqani	Pjesërisht pranuar	Grupi punues ka shqyrtuar kërkesën për mbështetje me pajisje për hapjen e një biznesi të vogël dhe ka vlerësuar se kjo kërkesë bën pjesë në fushën e subvencioneve dhe mbështetjes për ndërmarrësinë lokale. Në këtë drejtim, është udhëzuar që kërkuuesi të ndjekë procedurat përkatëse pranë Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik , ku shpallen thirrjet publike për subvencione, në përputhje me kriteret dhe planifikimet buxhetore të vitit.

				Komuna mbetet e angazhuar në përkrahjen e nismave private që krijojnë vende pune dhe zhvillim ekonomik lokal, dhe inkurajon aplikimin në kohë të rregullt në thirrjet që shpallen gjatë vitit.
Qytetarë [F fermerë]	Fitim Istogu	Subvencione për prodhuesit e perimeve dhe fermerët	Pjesërisht pranuar	Fermerët të përcaktohen në fushat për subvencion dhe të ndjekin thirrjet e ministrisë

Analiza e pjesëmarrjes sipas gjinisë

Me qëllim të sigurimit të një pasqyre të qartë mbi nivelin e përfaqësimit të grave dhe burrave në dëgjimet buxhetore, në vijim paraqitet një përmbledhje grafike e pjesëmarrjes. Kjo analizë synon të evidentojë nivelin aktual të përfaqësimit gjinor dhe të shërbejë si bazë orientuese për veprime të mëtejshme, në funksion të arritjes së balancimit të plotë gjinor dhe të rritjes së përfshirjes së grave në proceset vendimmarrëse komunale.





Ky raport i pjesëmarrjes tregon një përmirësim të përfaqësimit të grave krahasuar me dëgjimet buxhetore të viteve të kaluara. Ky trend pozitiv duhet të mbështetet dhe të nxitet më tej përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe krijimit të mekanizmave lehtësues që nxisin pjesëmarrjen aktive të grave në proceset vendimmarrëse.

Përfundime dhe rekomandime

Të dy dëgjimet publike dëshmuar gatishmërinë e Komunës së Drenasit për të garantuar një proces buxhetor të hapur, gjithëpërfshirës dhe transparent, duke u krijuar qytetarëve dhe grupeve të interesit mundësinë të shprehin nevojat, shqetësimet dhe prioritetet e tyre. Pjesëmarrja aktive dhe diskutimet konstruktive treguan qartë se komuniteti është i gatshëm të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe zhvillimin e komunës.

Në këtë drejtim, rekomandohet që krahas ruajtjes së formatit aktual të dëgjimeve, të krijohen **mekanizma shtesë dhe kanale të strukturuar komunikimi**, të cilat do të inkurajojnë veçanërisht pjesëmarrjen e grave, të rinjve dhe komuniteteve joshumicë. Kjo qasje do të sigurojë përfaqësim sa më të gjerë, do të fuqizojë zërin e grupeve të nënpërfaqësuar dhe do të garantojë që procesi buxhetor të mbetet realisht gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit.

Ky raport mund të shërbejë si dokument bazë për të gjitha strukturat vendimmarrëse të komunës dhe njëkohësisht si dëshmi konkrete e përkushtimit të Komunës së Drenasit për të dëgjuar qytetarët dhe për të ndërtuar politika publike të bazuara në nevojat reale të komunitetit.

**Ky raport është përpiluar dhe miratuar nga Grupi Punues përgjegjës për Hartimin e Planit të Dëgjimeve Buxhetore.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore
(KAB) 2026-2028

Biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike etj

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M/F	Nënshkrimi
1	Elmi Yhoda		M	
2	Fitore Fetahu		F	
3	Hafiz Mujco		M	
4	Gentrit	Mulaku	M	
5	Florim	Kigjiri	M	
6	Kastriot	Bevorun	M	
7	Fitim ISTOGU	ISTOGU	M	
8	EZON	QORRI	M	
9	Sabrije	Trbn	F	Sabrije
10	Sami	Uka	M	
11	BESMIR	MUDA	M	
12	Nexmedin Morina		M	
13	SPARI	KRASNICI	M	
14	Xhemal Bytyqi	Bytyqi	M	
15	STEFAN KRASNICI		M	
16	Mehmet Krasnici	KRASNICI	M	
17	Alban Brahimi	Brahimi	M	
18	HAMDI KRASNICI		M	
19	Bali Mulla	Mullaku	M	
20	Hajrush Musaj		M	
21	MIGJEN	BEKA	M	
22	Uzet	Abdyli	M	
23	Vehbi	Ferhan	M	
24	Bonart	Pecani	M	
25	Rina Gashi-Hajdari		F	
26	Artinda Munishi		F	
27	Zumrije Halili		F	

28	Hajrije	KASTRATI	F	H.K
29	Iir	Bensha	M	B's SMO →
30	Arbenje	Blaroug	R	Acw
31	Lindona	Fejzi-Hjerd	F	Arben
32	Lumturije	Kyren Vlah	F	Arben
33	Arbeni	Rama	F	Ar
34	Etnerm	Francu	M	Ar
35	Djellza	Bensha	F	Arben
36	RAMIZ	LESTRANI	M	Ar
37	SHPEARD HOXHA	HOXHIT	M	Arben
38	FLUIDA	NIKA	F	Arben
39	Albulena	Saliuku	F	Arben
40	pereti	SINANI	M	Arben
41	Muhamet	Gjoka	M	Arben
42	Lumturije	Gashi-Krapi	F	Arben
43	Agnesi	Kastrati-Bucalli	F	Arben
44	ENRIT	GLAROVA	M	Arben
45	Arian	Krasniji	M	Arben
46	Laureta	Thygi	F	Arben
47	Nexhmedin	Gruda	M	Arben
48	Enx Florije	Uka	F	Arben
49	Bekim	Dobra	M	Arben
50	Ramiz Hadron		M	Arben

51	KUSHTEM BAKRAKTARI		M	Arben
52	ARBEN	SHAZA	M	Arben
53	Arje	Vesli	F	Ar
54	Arben			
55	Sadete	Hocari	M	Ar
56	Vlorza	Zarigi	F	Ar
57	Gendrac	Zugaku Morina	F	Ar
58	Alhna	Mona Zangi	F	Ar
59	Hasime	Muly Hoxhmi	F	Ar
		Gashi	F	Ar

P.s: Ne këtë takim do të ketë edhe fotografi dhe me nënshkrimin e juaj pajtoni që fotografi të përdoren për komunikim zyrtar.

60. Blenta Bensha F Ar



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore
(KAB) 2026-2028

Administratorë, këshilla lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të
kufizuara, punëtor shëndetësor etj

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M/F	Nënshkrimi
1	XHAFER	DOBËDOLAKI	M	Xhaferi
2	Imri Bajraktari	Kidmoreki	M	Bajraktari
3	KADRI	AJAZI	M	Kadri
4	HETEM	AJAZI	M	Hetem
5	HABIB	GASHI	M	Habib
6	GANI KRASNI	OG	M	Gani
7	Egroma	Terdenci	F	Egroma
8	Rustem	Bullaku	M	Rustem
9	LSIAT	SJIA	M	LSIAT
10	ZEKË LLANG	PAKLEK	M	Zekë
11	KASRIOT HOXA	DAMANEK KRAIKOV	M	Kasriot
12	BIJAR DERVISHI	SHKATEVË EVO	M	Bijar
13	Anberije Gllareva	Drenas	F	Anberije
14	Luljeta Nebihu	Drenas	F	Luljeta
15	Kimete Qorri	Drenas	F	Kimete
16	Bislime Dvorani	Drenas	F	Bislime
17	Eknem Franca	DRENAS	M	Eknem
18	Liridona Fejza-Ajze	Fejza-Ajze	F	Liridona
19	LIRIDONË	MULAKU	F	Liridone
20	HABIB TANIPI	DRENASI	M	Habib
21	BAJKAN Gllari	TERSTENIK	M	Bajkan
22	Sheh 13 egro	SHKURBI	M	Sheh
23	MURAT ELHANI	SHKURBI	M	Murat
24	Enver Hoxha	SHKURBI	M	Enver
25	AFRIM GLLAREVA	GLLAREVA	M	Afrim
26	Djelza Bardha	Llapushnik	F	Djelza

27	Halim Janova	Jan Koca	M	
28	Jalil Janova	L. Janova, Sankoc	M	
29	Faiz	Gash	M.	
30	Halit	Gashi	M	
31	Lauder	Truji	F	
32	Arian Krasniqi	Amiraj	M	
33	Muhamet	Amiraj	M	
34	Agnesë Kastrioti Buci	Amiraj	F	
35	Lumnye	Gjoshi - Krasni	F	
36	PETRI	GASHI	M	
37	Hexumedin	Gruda	M	
38	Albulena Saliuku	Saliuku	F	
39	FZUIDA	NIKA	F	
40	Bekim	Dobra	M	
41	Arbou	Shala	M	
42	KUSHTRI	BASRAKTARI	M	
43	EMRIT	GLAREVA	M	
44	Ramiz Hadri		M	
45	Elmi Yhola	Negroç	M	
46	Armond	Devashitico	M	
47	Arji	Vendi	F	
48	Arji	Arji	M	
49	Sedebe	Zarigi	F	
50	Vlora	Zucaku	F	
51.	Gendiana	Marina Farji	F	
52.	Alino	Mulaj Hajrini	F	
53.	Hasime	Gashi	F.	
54.	Blerita	Beusha	F	
55.	ARIANIT	BATA	M	

P.s: Ne këtë takim do të ketë edhe fotografi dhe me nënshkrimin e juaj pajtoni që fotografitë e takimit të përdoren për komunikim zyrtar.